

## Aktivitetet e organizuara nga QKKDM-ja në Stamboll - 2015

Organizimi i kurseve në QKKDM-Stamboll, nga drejtori i QKKDM-së ,z. Qamil Bytyqi,  
Kursi i gjuhës shqipe në grupe të ndryshme në Qendrën Kulturore në Stamboll, grupi i katërt.



Qendra Kulturore e Kosovës, bashkë me shoqatat ( gjashtë shoqata), më 21 shkurt, e shtunë, e do ta organizojë kremtimin e Pavarësisë së Kosovës në Bayrampaşa, kurse më 28 shkurt do ta organizojë kremtimin e Pavarësisë së Kosovës në Bashkinë Küçükçekmece në Stamboll.



Në parkun “Adem Jashari” u përkujtua heroi ynë kombëtar Adem Jashari. Në këtë ceremoni përkujtimi morën pjesë konsulli i përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë në Stamboll , Agron Tare, dhe konsulli i përgjithshëm i Republikës së Kosovës në Stamboll , Rrahim Morina.



Në Qendrën Kulturore të Kosovës në Turqi, në bashkëpunim me Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës në Stamboll, u kremtua 8 Marsi –festa e gruas.

Në fund të programit u shfaq filmi dokumentar “Gratë e suksesshme kosovare nga Kosova në Turqi”.



### **Punëtorja “Kinemaja për fëmijë”**

Kjo punëtorja do të udhëhiqet nga profesoresha e Universitetit të Stambollit (radio TV dhe Kinema), znj. Nilüfer Pembecioğlu, në bashkëpunim me Diar Xanin, student i PhD doktoraturë në Universitetin e Stambollit (radio TV dhe Kinema).

Kjo punëtorja do të mbahet më 21.2.2015, e shtunë , në Qendrën Kulturore të Kosovës në Stamboll. Programi do të fillojë në orën 12:00 dhe do të vazhdojë për disa orë.

Kjo punëtorja u dedikohet fëmijëve prej moshës 5 deri në 15 vjeç.

Pjesëmarrësit e rinj do ta kenë rastin të mësojnë dhe të kuptojnë më shumë rreth kinemasë për fëmijë. Po ashtu, në këtë punëtorja, fëmijët do të kenë rast të shohin edhe një film, i cili do të përzgjidhet nga trajnuesit.



### **Takim me shqiptarët e Silivrisë**

Më 23 mars 2015 u takova me shqiptarët e Silivrisë, në shoqatën e tyre. Ata janë shpërngulur në Turqi më 1924 nga Vilajeti i Manastirit, i mbetur tash në territorin e Greqisë.

Këta janë shpërngulur nga fshati Viçishte i rrethit Kesriye. I gjithë fshati është shpërngulur.

Numri i tyre arrin në 2062 veta. Shpërngulja është bërë në bazë të marrëveshjes mes Greqisë dhe Turqisë për shkëmbimin e popujve, në vitet 1924-1925.

Në fillim, ata u vendosën në Mersin. Meqë ky vend nuk u pëlqeu, valiu i qytetit Adana, me origjinë shqiptare, i fton të vendosen në Adana, por as këtu nuk pranojnë, kështu që vendosen në qytetin Kahramanmaraş, rreth 1.100 km larg Stambollit.

Pesë-gjashtë muaj pas qëndrimit në Kahramanmaraş, rreth 20-30 familje vendosen në Silivri, rreth 70 km larg Stambollit; 40-50 familje nga Kahramanmarashi vendosën në Manisa, një qytet rreth 500 km larg Stambollit.

Tani në Kahramanmaraş jetojnë afërsisht 100-150 familje shqiptare.

Në mesin e këtyre shqiptarëve kishte edhe të shpërngulur nga fshati Reva të rrethit Kesrije. Edhe këta vendosen në fshatin Fakır Ali të rrethit të Çayıralan, në qytetin Yozgat të Turqisë, rreth 650 km larg Stambollit.

Shqiptarët e Silivrisë, për të qenë më të organizuar, e kanë themeluar Shoqatën e Manastirlive në Silivri.

